# DËSHMI ARKIVI

**A-468553**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbledhja e Këshillit të Sigurimit, reagon Bardhi: Shqiptarët nuk kanë nevojë për spektakël institucional - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/mbledhja-e-keshillit-te-sigurimit-reagon-bardhi-shqiptaret-nuk-kane-nevoje-per-spektakel-institucional/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 11:18:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 11:14:01 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ee3ed4767485c3bb75875d9fc0438be13d625b2fc433812db2c657cef205645d` |
| TEKSTI | `51c451669e4e89ab78697bf58ffaa4d68e607d9ccabb36ecaa471bccd7a96581` |
| PAMJA | `e5fdaf9021bfc874fec633fe47d00e52cbc33bf71262dea2c31715b2c46e6ff4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `75402e37b0e8900e2c5760d9299a049bab29e1b51f3d352dd960ac7b61a0bfd7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/75402e37b0e8900e2c5760d9299a049bab29e1b51f3d352dd960ac7b61a0bfd7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJMI I FUNDIT | POLITIKË

# Mbledhja e Këshillit të Sigurimit, reagon Bardhi: Shqiptarët nuk kanë nevojë për spektakël institucional

25 Shtator 2026 | 13:14

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Pas vendimit të Presidentit Bajram Begaj për të mbledhur Këshillin e Sigurimit Kombëtar, pas masës së arrestit ndaj ish-drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni, ka reaguar kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, i cili thotë se vendi nuk ka nevojë për spektakël institucional.

Sipas Bardhit, Presidenti duhet të japë përgjigje lidhur me verifikimet e kryera përpara dekretimit të Vlora Hysenit në krye të SHISH, ndërsa ngre pikëpyetje edhe për sigurinë e informacionit të klasifikuar dhe funksionimin e institucionit.

“Shqiptarët nuk kanë nevojë për një mbledhje formale dhe as për një shfaqje institucionale. Ata nuk kanë nevojë që të mblidhet Këshilli i Sigurimit të Gysit. Qytetarët kanë nevojë për përgjigje konkrete.

Pyetja e parë dhe më e rëndësishme që i drejtohet Bajram Begajt është e thjeshtë:

Mbi çfarë verifikimesh u mbështet vendimi për dekretimin e Vlora Hysenit në krye të SHISH dhe çfarë verifikoi Presidenti dhe çfarë nuk verifikoi institucioni i Presidentit përpara dekretimit?

Po aq serioze janë pyetjet që lidhen me sigurinë e informacionit të klasifikuar, burimeve njerëzore dhe informacionit sensitiv që administron SHISH. Nëse ekziston apo ka ekzistuar një rrezik që informacionet e këtij institucioni, identitetet e burimeve apo të informatorëve të jenë ekspozuar ndaj strukturave kriminale ose shërbimeve të vendeve jo mike, atëherë kemi përpara një çështje me pasoja potencialisht shumë të rënda për sigurinë kombëtare.

Gjatë këtyre dy viteve janë ngritur publikisht pretendime dhe shqetësime serioze për mënyrën se si ka funksionuar SHISH dhe për marrëdhënie të pretenduara ndërmjet individëve të caktuar dhe strukturave të krimit të organizuar. Bajram Begaj duhet të sqarojë nëse këto shqetësime janë verifikuar ndonjëherë nga institucionet përgjegjëse dhe, nëse po, cilat kanë qenë përfundimet e këtyre verifikimeve.

Nuk i kërkojmë Presidentit të ndërhyjë në hetimet e SPAK-ut apo në vendimmarrjen e gjykatave. I kërkojmë të japë llogari për përgjegjësitë e veta institucionale.

Prandaj, Këshilli i Sigurimit Kombëtar nuk mund të përdoret si zëvendësim për llogaridhënien. Presidenti, njëlloj si Kryeministri, duhet të përgjigjet për vendimmarrjen e tij. Duhet të shpjegojë çfarë verifikoi, çfarë dinte, çfarë nuk dinte dhe çfarë masash janë

## LAJMI I FUNDIT

13:04 **Zelensky: Trump ka marrë vendimin përfundimtar të na japë licencë për raketat Patriot**

12:48 **Masa e SPAK ndaj Vlora Hysenit, Begaj mbledh të hënën Këshillin e Sigurimit Kombëtar**

12:29 **Vuçiç akuzon Rashiç se me mbështetjen për Listën Studentore “po zbaton urdhrat” e Kurtit**

12:28 **Këshilli Bashkiak i Elbasanit voton pro bashkimit me Cërrikun dhe Belshin**

12:25 **Festoi golin duke imituar një të shtënë arme, përjashtohet futbollisti i Izraelit (VIDEO)**

12:20 **Këshilli Bashkiak i Korçës voton pro bashkimit me Maliqin**

TESTIM

marrë për mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Shqiptarët nuk kanë nevojë për një President që shfaqet vetëm pasi kriza ka shpërthyer. Shqiptarët kanë nevojë për një President që merr përgjegjësi, jep llogari dhe garanton se institucionet e sigurisë së Republikës nuk përdoren për interesa politike apo kriminale. Prandaj, përpara çdo mbledhjeje formale të Këshillit të Sigurimit Kombëtar, Bajram Begaj duhet t'u japë shqiptarëve transparencën që meritojnë.

Jo propagandë. Jo formalitet. Jo heshtje. Përgjegjësi dhe transparencë", shkruan ndër të tjera Bardhi.

Në mbledhje pritet të marrin pjesë kryeministri Edi Rama, kryetari i Kuvendit Niko Peleshi, si dhe ministrat e Mbrojtjes, Ermal Nufi, të Brendshëm, Ervin Demo, të Financave, Petrit Malaj, të Jashtëm, Ferit Hoxha, dhe të Energjisë dhe Infrastrukturës, Enea Karakaçi.

Nga Kuvendi pritet të jetë i pranishëm edhe kryetari i Komisionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Bledi Çuçi.

Sipas përcaktimeve ligjore, në mbledhje marrin pjesë gjithashtu Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit", shkruan Bardhi.

**Shiko në:**


## LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | LAJMI I FUNDIT

### Tragjedi në Detin Kaspik, 14 ushtarë kazakë humbin jetën gjatë stërvitjes

Katërmbëdhjetë ushtarë kazakë kanë humbur jetën në Detin Kaspik, pas një incidenti gjatë një stërvitjeje detare të Forcave Detare ndërsa tre të tjerë janë shpëtuar....

11:58 | 25/09/2026

AKTUALITET | LAJMI I FUNDIT | POLITIKË | VENDI

### Deputetja Luarasi: Reagimi i ish-drejtueses së SHISH ndaj gazetares është i papranueshëm

Deputetja e Partisë Socialiste, Iris Luarasi, ka reaguar përmes një statusi në rrjetet sociale lidhur me reagimin e ish-drejtueses së SHISH-it ndaj gazetares Klodiana Lala...

11:07 | 25/09/2026

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI

### Deputeti i PDK-së bën thirrje: Të lëmë zgjedhjet dhe të fokusohemi te Haga

I ftuar në "Now" me Esmeralda Mulajn, deputeti i PDK-së, Artan Behrami, bëri thirrje që fokusi kryesor i politikës në Kosovë të rikthehet te çështja...

10:47 | 25/09/2026




Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.